



## Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

### RAPORT

<b>Për:</b>	<b>Ertan Munoglu – Menaxher i Programit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv</b>
<b>Data :</b>	<b>19 prill 2011</b>
<b>Subjekti :</b>	<b>Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Integritime Evropiane</b>

#### HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit së Kryesisë së Integritimeve Evropiane me datën 19 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z. Shaqir Mala – Kryesues, z. Kastriot Jashari - Zv.kryesues, anëtarë z. Hilmi Mustafa, z. Ibrahim Hajdari dhe znj. Ajshe Bërveniku. Në takim po ashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, dhe z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për integritime Evropiane dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

## **PËRMBLEDHJE:**

Mbledhjen e hapi z. Shaqir Mala me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës së Kolegjiut për Integritime Evropiane në vitin 2011.

- Implementimi i PVPE-se për vitin 2011;
- Implementimi i Rregullores për Zyre Komunale për Integritime Evropiane;
- Fuqizimi i rolit të Zyrtarëve Komunal për Integritime Evropiane;
- Ngritja e kapaciteteve dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira;
- Koordinim i projekteve të BE-se së bashku me AZHR (takim me ZNKE dhe AZHR).

Takimi kishte për objektiva edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Integritime Evropiane.

### **Takimi i radhës**

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut për Integritime Evropiane të mbahet të enjten me datën 05.05.2011 në Prishtinë.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Analiza e PVPE-së
2. Nxjerrja e matricës nga PVPE

Në takim do të ftohen Sekretarët e Përhershëm dhe stafi relevant nga MAPL dhe MIE.

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.